PIK

Rr. Pjetër Bogdani, Nr. 37
Tiranë, Shqipëri
info@pik.al / www.pik.al

# VENDIM I ASAMBLESË

# SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE

# TË

# PIK SHPK

Sot më 01.06.2020, ora 11.30, pranë selisë së shoqërisë me vullnetin dhe praninë e të katër ortakeve zotërues të 100% (një qind për qind) të kapitalit të nënshkruar dhe shlyer në tërësi të Shoqërisë përkatësisht:

- **Z. Ilir Daci**, zotërues i 20% të kapitalit të Shoqërisë
- **Z. Glon Bakalli**, zotërues i 20% të kapitalit të Shoqërisë
- **Z. Alban Fejzaj**, zotërues i 40% të kapitalit të Shoqërisë dhe
- **Z. Ardit Koleci**, zotërues i 20% të kapitalit

u mblodh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë **PIK SHPK**, shoqëri e krijuar dhe që ekziston sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik të regjistrimit të biznesit L12316016A dhe me seli të ndodhur në adresën: Rr. Pjetër Bogdani, Nr.37, Kati 2, Tiranë, (më poshtë quajtur "Shoqëria").

Ortakët pranojnë dhe janë dakord të proçedojnë me mbajtjen e kësaj Asambleje sipas nenit 83 të ligjit "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe statutit të Shoqërisë, pavarësisht mos ndjekjes së procedurës së thirrjes së asamblesë. Në këtë mbledhje të asamblesë së përgjithshme me unanimitet:

## VENDOSËN

1. *Zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë*

Miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë nëpërmjet:

a. fitimit të pashpërndarë në shumën në Leke 149,900, sipas bilancit dhe pasqyrave financiare të depozituara pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

2. *Emërimi i ekspertit për përgatitjen e raportit mbi zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë*

Emërohet në cilësinë e ekspertit kontabël të pavarur Z. Ilir Daiu, mbajtës i licensës profesionale me nr. 361, për të vlerësuar dhe përcaktuar vlerën e fitimit dhe kapitalit në total të Shoqërisë si rezultat i fitimit nga kjo e fundit. Eksperti emërohet dhe autorizohet gjithashtu për të përgatitur raportin përkatës mbi zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.

3. Autorizimin e Znj. Neriza Brami dhe/ose Juxhin Shehaj të kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme, së bashku ose veç e veç, me qëllim depozitimin dhe regjistrimin e këtij Vendimi dhe të akteve të tjera në lidhje me të, në Regjistrin Tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit ose pranë çdo autoriteti tjetër publik ku ky depozitim është i nevojshme.

PIK

Rr. Pjetër Bogdani, Nr. 37
Tiranë, Shqipëri
info@pik.al / www.pik.al

**ORTAKËT**

**Z. Alban FEJZAJ**

**Z. Ardit KOLECI**

**Z. Ilir DACI**

**Z. Glon BAKALLI**

PIK
L12316016A